

**LULZIME KRYEMADHI**

**E FOLMJA E PEQINIT DHE VENDI I SAJ  
NË STRUKTURËN DIALEKTORE TË SHQIPES  
- POZICIONI GJEOGRAFIK DHE HISTORIA**

Peqini është një vendbanim i lashtë ilir në bregun e djathtë të Shkumbinit të poshtëm dhe bën pjesë në njësinë fiziko-gjeografike të Ultësirës Perëndimore dhe në aspektin rajonal gjeografik, në Rajonin Perëndimor të vendit. Është qytet gati 2000 vjeçar. E kaluara e lashtë sidomos ajo mesjetare pasqyrohet në monumentet historike të qytetit, si kalaja dhe xhamia me kullën e sahatit. Gjetjet arkeologjike dëshmojnë për faktet se ai ka ekzistuar njëherësh me qytetet e tjera më të lashta të vendit tonë, gjë që dëshmon dhe për një të folur me ndryshime në periudha të caktuara të jetës ekonomike-shoqërore të banorëve të qytetit. Pozicioni gjeografik, ia jepte atij një mundësi të tillë, duke qenë i vendosur përgjatë rrugës së vjetër të Kandavisë e më pas të asaj të Egnatias, i njohur me emrin Klaudiana (Klodiana). Ky emër i lashtë është vendosur nga pushtuesit romakë për nder të prijësit të tyre. Gjurmët më të lashta në rrethin e Peqinit i takojnë prehistorisë në vendin e quajtur Gallovë afër fshatit Ballagat ku është gjetur një sëpatë, ekan prej guri të brimuar e punuar me gurë jeshilë. Kjo sëpatë është e gjatë 21 cm dhe tipologjikisht i takon epokës së bakrit dhe asaj të bronzit të hershëm. Në lëvizjet historike të vitit 1431 thërritet me emrin Biklenet dhe më pas Peklin. Nahija e Peqinit jepet me emrin “Nahia Markesh”. Kjo na shtyn ta lidhim fjalën Peqin me periudha turke. Ndofta ajo e ka prejardhjen nga fjala turke Bekleyen (ai që pret, pikë pritje). Kjo ka bërë që të kemi përdorim dhe të shumë fjalëve turke Sipas ndarjeve administrative të sistemit turk, Peqini konsiderohej Mëdërllik (Krahinari). Klodiana është ndër qytetet ilire që udhëtarë të ndryshëm shpeshherë e kanë identifikuar me qytetin e Peqinit. Nga autorët antikë Klodiana përmendet si një stacion i rëndësishëm i Via Egnatias (në shekullin e III) në itinerarin e Antonimeve ku bashkoheshin 2 degëzimet e saj, njëra nga Dyrrahu (Durrësi) dhe tjetra nga Apollonia. Kjo rrugë është ndërtuar midis viteve 146-120 p. e. s. Rruga gjatë luginës së Shkumbinit e merr emrin Egnatia me sa duket nga qyteti Egnatia në Italinë

Jugore, buzë Adriatikut i banuar nga fisi Ilir i Japigëve, të cilët patën kapërcyer Adriatikon, por të tjerë mendojnë se kjo rrugë mori emrin e atij që e ndërtoi, Konsullit Romak Gaiës Egnatius.

Rrethi i Peqinit shtrihet në qendër të Shqipërisë dhe përshkohet nga lumi Shkumbin, i cili e ndan atë në dy pjesë. Peqini shtrihet ndërmjet lartësive 17 deri në 757 m mbi nivelin e detit. Rrethi i Peqinit shtrihet midis gjerësisë gjeografike veriore 40° 57' dhe 41° 16' dhe gjatësisë gjeografike lindore 19° 40' dhe 19° 55'. Brenda këtyre kufijve Peqini ka një sipërfaqe prej 191 km<sup>2</sup>. Peqini është një vendbanim i lashtë ilir në bregun e djathtë të Shkumbinit të poshtëm. Gjatë mesjetës së vonë u zhvillua si qendër tregtare e zejtare. Nga ana administrative ai bën pjesë në prefekturën e Elbasanit. Pothuajse, në qendër të krahinës së Peqinit, në buzë të bregut të djathtë të lumit Shkumbin, ndodhet qyteti i vogël i Peqinit, qendër ekonomike dhe administrative e krahinës. Në Peqin ka pasur një qytet antik. Shenja të periudhës romake janë jo vetëm ndonjë toponim latin, që gjejmë këtu, por edhe kalaja e vjetër, e cila është rindërtuar më vonë. Populli i Peqinit është pjesëmarrës aktiv në të gjitha ngjarjet historike të vendit. Nga radhët e tij kanë dalë patriotë e lufëtarë të shquar, intelektualë e veprimtarë të përkushtuar për çështjen kombëtare në fushat politike, akademike kulturore e sportive si: Mustafa Gjinishi (luftëtar); Rifat Teqja (Artist i popullit) Dirigjent i orkestrës së operës dhe Baletit; Ferdinand Deda (Artist i merituar) Dirigjent i parë i Orkestrës simfonike të Radiotelevizionit Shqiptar; Vëllezërit Hudhri (Ferit, Bujar) botues të suksesshëm; Emine Gjata (soprane lirike); Behije Çela, figurë e njohur e popullit tonë për rolin e Hajries tek komedia “Prefekti”; Murat Manahasa, pedagog, i cili njihet si shkencëtar për prodhimin e kreolinës në vendin tonë; Ahmet Shqarri, gazetar sportiv; Bujar Cani lojtar i kombëtares shqiptare; nuk lëmë pas Daniel Godellin, kampionin botëror në peshëngritje. Nga të gjithë vizitorët e huaj Peqini dhe krahina e tij përmendet për popullin e tij bujar dhe mikpritës, për shtëpitë e kopshtet e bukura, kodrat e veshura me ullinj e gjelbërim, si dhe fushat e gjëra pjellore që lumi Shkumbin i përshkon fund e krye.

### **E folmja e Peqinit**

E folmja e Peqinit, është një e folme geqe-jugore-perëndimore pak a shumë unike, por në disa raste afron me të folmen geqe-perëndimore. Studimi për të folmen e Peqinit është hartuar në bazë të gjurmimeve, që janë bërë në qytetin e Peqinit, dhe në krahinat përreth. Për këtë studim është kaluar në çdo cep të Peqinit, ku janë takuar banorë të zonave të

## E folmja e Peqinit dhe vendi i saj në strukturën dialektore të shqipes...

ndryshme, duke filluar nga Karina kufi me Rrogozhinën, Cacabeza, Metallej kufi me Tiranën, deri te Gjocaj kufi me Ballagatin e Lushnjës, Bishqemi kufi me Elbasanin, Pekishti kufi me Belshin, bisedat me të cilët kanë mundësuar për njohjen nga afër me mënyrën e të folurit dhe të arrihet në përfundim që e folmja e Peqinit është një e folme gege-jugore-perëndimore dhe pse ndonjëherë kalimtare, kjo në varësi dhe të faktorit social. Rrethi i Peqinit shtrihet në qendër të Shqipërisë dhe përskohet nga lumi Shkumbin, i cili e ndan atë në dy pjesë, ku bie në sy dhe e folura e dy dialekteve. Gjatë bisedave konstatohet që poshtë lumit Shkumbin si pasojë e pozitës gjeografike, bien në sy influenca të toskërishtes, përdorimi i zanores **e** dhe i zanores **ë** (*kemba, këmba*), apo i grupit **-ua-** (*krua, ftua*), kurse në pjesën sipër Shkumbinit bie në sy dialekti i veriut, përdorimi i **a-**së, apo i **o-**së, *nona-nana*).

Karakteristike është përdorimi i bashkëtingëllores grykore, ndërthembore **-th** që dëgjohej rregullisht në variantin **-th-h**. E folura hundore bie shumë në sy gjatë bisedave me një pjesë të banorëve të Peqinit. Të *th<sup>h</sup>ash, th<sup>h</sup>ika, th<sup>h</sup>u*.

Të marrësh përsipër nismën e shqyrtimit e karakteristikave gjuhësore të së folmes së një bashkësie dhe, më pas, të pasqyrosh tiparet dhe veçantitë e saj, do të thotë në radhë të parë të jesh apo ndjehesh pjesë e brendshme e kësaj bashkësie, duke depërtuar thellë në strukturat gjuhësore, në mendësinë e saj, në botën e së kaluarës e të sotmes, në mendimet, vlerat, gjykimet, paragjykimet dhe, njëkohësisht, në përditshmërinë e veprimtarisë së saj. Idiolekti, apo e folmja e çdo individit modelohet dhe formësohet më së pari në gji të një bashkësie të vogël. Individit është porta përtej së cilës fshihen karakteristikat gjuhësore të një kombi, krahine apo grupi social, përderisa pranohet që idiolekti është qeliza bazë e së folmes së individit<sup>1</sup>, dhe nëpërmjet shoqërizimit të tij, edhe e njësisive më të larta: grupit familjar, shoqëror e deri te pjesa më e lartë që është gjuha e krejt kombit përkatës. Sa më pranë e sa më thellë t'i shkojmë studimit të gjuhës a ligjërit të individit, si pjesëtar i një bashkësie të dhënë, aq më mirë do të mund të depërtojmë edhe në vetë dialektin a gjuhën e njësisë më të madhe ku individit përfshihet. Sapo vendos të zbulosh një "enigmë" të tillë, nëse do të mund t'i qanin për një moment kështu veçantitë gjuhësore të një bashkësie të caktuar, përballesh natyrshëm me një mendim sa të çuditshëm, aq edhe real.

<sup>1</sup> Gj. Shkurtaç, J. Gjinari, *Dialektologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2003, f. 41.

### Kategorizimi i fjalëve sipas përkatësisë moshore

Biseda me persona të moshave të ndryshme ka çuar drejt një identifikimi të ndryshimeve dialektologjike në vite. Kjo nismë përbën në vetvete një tentative për të hedhur dritë sadopak në ndikimin e faktorit moshë, në përzgjedhjen e formave gjuhësore tek folës të ndryshëm gjatë komunikimit të përditshëm. Këto dukuri, disa prej të cilave prekin gati të gjitha grupmoshat e, disa të tjera, shfaqen tipike vetëm për grupmosha të caktuara të veçorive gjuhësore që karakterizojnë gjenerata të ndryshme, me qëllim parësor përcaktimin e veçorive tipike të çdo grupimi, si dhe pasqyrimin nëpërmjet tyre të diferencimeve moshore, lidhur me shfaqjen dhe praninë e dukurive gjuhësore tipike. Qëllimi i kësaj pike mbështetet në pasqyrimin e shtrirjes dhe përdorimit të dukurive tipike të së folmes së Peqinit në grupmosha të ndryshme, duke filluar me grupmoshën 10-12 vjeç, deri në grupmoshën 70-80 vjeç. Ajo që është vënë re është se mosha e tretë i ka ruajtur tiparet e të folurës dialektore, gjë që jo në pak raste ruhen dhe në brezat e mëposhtëm, si: *12/ dymdhit, u gdhifsh shnosh*. Në moshat 70-80 vjeç bie në sy përdorimi i theksuar i **th**-s grykore (the, thua, rënia e bashkëtingëllores / b/ : *mroje* (mbroje), *rrumullak* (rumbullak), *menja* (mendja); i bashkëtingëllores *d*: *ner* (nder), *miner* (minder); zëvendësimi i bashkëtingëllores **r**, në veçanti ne qytet dhe ne zonat kufi me Tiranën, me bashkëtingëlloren *n*: *bona* (bëra), *e gjon* (e gjerë). Tek kjo moshë bie në sy dhe përdorimi i fjalëve turke në përdorim të gjerë: *dallap, sabah, aksham, kurban, muftar, resme, xhezme, penxhere*. Në grupmoshat 30-40 vjeç hasim përdorime si: *omëlsin*, por dhe *ëmbëlsirë, shemëll*, por dhe *shembull*. Në moshat më të vogla hasen tendenca të një të foluri standard.

### Ndryshimi i gjuhës si thjeshtëzim

Analiza është përqendruar dukshëm në shfaqjen e tipareve dialektore të kësaj të folmeje, shtrirë në pjesë të ndryshme të ligjëratës si dhe hedhjen dritë mbi faktin se si ka ndikuar faktori moshë në realitetin gjuhësor të pasqyruar. Duke iu referuar kësaj teorie, në të folmen e Peqinit, gjejmë forma të tilla të fjalëve si: *mshoju komve* (vrapo, ec shpejt), *mase* (mbase), *mlese* (mbulese), *e lçume* (e lëshuar), *noiher* (ndonjëherë), *mos u t/ hiq* (mos u tërhiq), *ni* (e ndjej), *mrena* (brenda). Kjo dukuri e asimilimit të tingujve drejt formës më të thjeshtëzuar të fjalës, ndodh, sepse njerëzit e konsiderojnë “shumë të mundimshme” të shqiptojnë tingullin **-d-**, **-b-**, apo tingujt e tjerë të strukturës ndërtimore të fjalëve të mësipërme apo edhe të shumë fjalëve të tjera. Shpeshherë këto ndryshime të formës së fjalëve janë bërë shkak i krijimit të dukurisë së homonimisë brenda një të folmeje apo

## E folmja e Peqinit dhe vendi i saj në strukturën dialektore të shqipes...

---

dialekti. I tillë është edhe rasti i emrit *nan* (nënë) dhe *nan* (nëntë), emrit *maj* (majë) dhe foljes *maj* (mbaj), emrit *za* (zërit) dhe foljes *za* (zë), emrit *daj* (dajë) dhe foljes *daj* (ndaj); mbiemrave *e ran* (e rëndë) dhe *e ran* (e renë) në të folmen e Peqinit, dukuri e cila, nëse do t'i referohemi shqiptimit standard të këtyre fjalëve (në veçanti tek moshat 12-17 vjeç) shkon drejt mospërdorimit. Gjatë studimit prania e këtyre tipareve, në pjesën më të madhe të dukurive, shkon në raport të drejtë me moshën e informuesve. Në përgjithësi te moshat e vogla vihet re një shkallë më e ulët e përdorimit të tipareve dialektore gjatë të folmes së tyre. Paraqitja e të dhënave gjuhësore në pjesë të ndryshme të ligjëratës, sipas grupmoshave të hetuara tregon se, përqindja më e madhe e pranisë së tipareve dialektore në të folmen e Peqinit, mbizotëron tek grupmosha më e vjetër e hetuar, tipare të cilat, me uljen e moshës, vijnë duke u ulur nga njëra grupmoshë në tjetrën, duke shfaqur, përgjithësisht, arritjet më të vogla në grupmoshën 11-12 vjeç. Folja *shkoj*: moshë 50-70 *vojta*, moshat më të ulëta *shkova*; siç shihet kemi ndryshim të rrënjës.

### Leksiku

Për disa individë elementet e marrë hua kanë konotacione të mashkullorisë ose të autenticitetit natyral: një lloj "prestigji i anasjelltë". Shumë pjesëtarë të klasës së ulët arrijnë vlera të ulëta tek ligjërimet e tyre vetjake dhe shpesh, ata, ndiejnë se duhet të imitojnë klasat më të larta dhe kjo ndodh ngaqë shtresat shoqërore më të ulëta janë të dëmtuara nga pamjaftueshmëria e gjuhës së tyre.<sup>2</sup> Nëse përpiqemi të incizojmë dikë, ndërsa është duke folur, do të vëmë re që ekzistojnë variante në shqiptimin e një foneme të vetme, në përzgjedhjen e fjalëve dhe gramatikës. Një pamje tradicionale e ndryshimit të gjuhës, shpesh e shprehur nga gramatikanët, është se ndryshimi i pavetëdijshëm ndodh në drejtim të thjeshtëzimit, konceptuar si një tendencë universale drejt përdorimit të përpjekjeve sa më minimale. Madje parashikimet i kanë karakterizuar proceset e ndryshimit si *rezultat i dembelëve*<sup>3</sup>. Duke iu referuar kësaj teorie, në të folmen e Peqinit gjejmë forma të tilla të fjalëve si: *funi* (fundi), *mlese* (mbulesë), *e lçume* (e lëshuar), *mos u t'hiq* (mos u tërhiq), *noi* (ndonjë), *sun e bëj* (s'mund ta bëj), *e ni* (e ndjej), *mrena* (brenda). Kjo dukuri e asimilimit të tingujve drejt formës më të thjeshtëzuar të fjalës,

---

<sup>2</sup> Gj. Shkurtaj, J. Gjinari, *Dialektologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2003.

<sup>3</sup> W. Labov, *Some Linguistic Principles*, *Sociolinguistics*, C.B.Poulson and Richard Tucker, U.S.A, 2003, f. 34. P. Trudgill, *Sociolinguistic variation and change*, Great Britain, 2002, f. 48.

sipas kësaj pikëpamjeje ndodh sepse njerëzit e konsiderojnë “shumë të mundimshme” të shqiptojnë tingullin **-d-**, **-b-**, apo tingujt e tjerë të strukturës ndërtimore të fjalëve të mësipërme apo edhe të shume fjalëve të tjera. Të gjithë folësit, vazhdimisht, prodhojnë në mënyrë të pavëmendshme shqiptimin e thjeshtëzuar të fjalëve të veçanta. Shpeshherë këto ndryshime të formës së fjalëve, (siç e përmendëm dhe më lart) janë bërë shkak i krijimit të dukurisë së homonimisë brenda një të folmeje apo dialekti. I tillë është edhe rasti i emrit *nan* (nënë) dhe *nan* (nëntë), emrit *maj* (majë) dhe foljes *maj* (mbaj), emrit *za* (zërit) dhe foljes *za* (zë), emrit *daj* (dajë) dhe foljes *daj* (ndaj); mbiemrave *e ran* (e rëndë) dhe *e ran* (e rënë) në të folmen e Peqinit, dukuri e cila resht së ekzistuari, nëse do t'i referohemi shqiptimit standard të këtyre fjalëve<sup>4</sup>. E folmja si një variant i gjuhës dialektore dhe si degëzim më i imët i saj ekziston në një pikë të banuar të territorit të asaj gjuhe. Dialekti peqinas nuk është shkëputur historikisht nga gjuha standarde. Megjithatë në të folmen e Peqinit disa fjalë përdoren me një kuptim të ri që largon pak a shumë nga kuptimi i parë që ka fjala:

emrat: **qok**, zakon (*kam një qok për t'bo*); **surrat**, dordolec, **pjasa**, çmimi (*e ka pjesen me t'met*); **mish**, berr (*i mish ka therë at natë*) **frym**, person (*sa frym bahet Shoqeti*);

foljet: **qas**, pranoj, fus në shtëpi (*s'qasimram*); **shtyr**, kapërxej lumin (*do shtyr lumin*); kapërdij bukën (*nuk m'shtyret*); **m'gjan**, më duket, më bahet, (*m'gjan se erdhe vet ti m'at nat*); **quk**, ngacmoj, nis (*ta quk vet fjalën*); **shij**, dërmoj plisin (*t'i shijm plisat*); **çel**, nxjerr zogj sqoka (*çeli qoka dhit zoq*); **treth** (qumshtin), i marr ajkën qumështit (*kto e trethin qumshtin ene e bajn djathin*) **eshk**, po, vetëm (*tokën e atij pata na gjith katuni se po un*); mbiemrat: **i dashëm**, **i lezetshëm**, **i kandshëm** (*a ma i dashëm mjalti se pekmezi*); **i bukur**, në Malësi ky mbiemër ka një përdorim shumë të gjerë; përdoret me kuptimet *i mirë*, *i shëndoshë*, *i fortë* etj. (*aj gruni doli i bukur, poi vogël; mushka jote a e bukur, sot e pash; m'doli e bukur delja*). Shumë kuptime ka edhe ndajfolja **bukur** (*e shiti bukur lopën*, shtrejt). Leksiku i gjuhës është i pasuruar, por gjithsesi takojmë fjalë, si: *groc* - vazo, *katruve* - shtamë, *pihata* – u lodha, *xhifteva* - e nxora (e theva) kamën, *devihone* - ballkon, *putrrej* – flas pa pushim, *trakllin* – njeri llafazan, *zerzele* - tërmet, *tërkuz*-litar, *qypal* - gurë i madh, *kryqe* - shami e zbukuruar që e mbajnë gratë në kokë, *ode e miqve* - dhomë

<sup>4</sup> M. Çeliku, *Vëzhgime mbi të folmen e Peqinit*, në “Studime filologjike”, IV, Tiranë, 1965, f. 125.

## E folmja e Peqinit dhe vendi i saj në strukturën dialektore të shqipes...

e madhe më e mira nga të tjerat, *korbull* - fuçi prej druri, *kaci* - lopatë e vogël për mbajtjen e zjarrit (hirit), *vorbe* - enë qeramike për zierjen e fasuleve, *nime* - ballkon, *nahi* - pjesë, *hebexhe-vonë* (u bë vonë), *teret* - thahet, *harar* - thes, *turru* - vrapo, *qete* - mace, *qylyke* - kazëm e madhe, *naxhake* - sopatë e vogël, *magrip* - enë qeramike, *hava* - në ajër, *perxhik* - njësi matëse (pëllëmbë e vogël), *vjedull* - dhëlpër, *kaposh* - gjeli, *ogiq* - viçi, *poliq* - i vogli i gomar. Gjithashtu përmendim fjalë nga fusha bimore *jasemin*, *arbachik*, *qepujkë*, *pras*, *nenexhik*.

### Fonetika

Theksi i fjalës në të folmen e Peqinit paraqitet si në të folmen e gjuhës standarde, pra në të përjashtohet, si: fjalët e huazuara nga turqishtja, *sexhade*, *sabah*, *xhezme*, *xhade*, *kafe*, ku theksi bie në rrokjen e fundit. Në të folmen e Peqinit hasen dhe përdorime të homografeve të pakta, si: *bab<sup>a</sup>* - *b<sup>a</sup>ba*, *tab<sup>a</sup>k* - *tabak<sup>a</sup>*.

### Zanoret

Në bazë të studimit të fonemave zanore e folmja e Peqinit vërehet se bën pjesë në arealin gjuhësor me tre seri fonemash gojore, të shkurtra, të mesme, të gjata. Zanoret e gjata dëgjohen në këto raste: Zanorja e theksuar e fjalëve protonike të cilave u ka rënë një ë- fundore.

Kështu: emrat e gjinisë femërore të trajtës së shquar *des*, *shpis*, *dajak*, *gjat*, *marr*, *shum*.

Zanorja që përftohet nga monoftongimi i të gjitha diftongjeve, kur ndodhet në rrokje fundore të mbyllur ose të hapur: *ftu*, *kru*, *mil*, *u kthyjn*.

Zanoret e theksuara me rrokje fundore të hapur: *na*, *ka*, *mi*, *sy*.

Zanoret e theksuara të disa fjalëve kur ndodhen në rrokje të mbyllur para disa tingujve likuidë, sidomos para **r**-së e më rrallë para **ll**-s: *gur*, *litar*, *ushtar*, *zall*, *fill*.

### Zanore të mesme

Në të folmen e Peqinit zanoret e theksuara që pasohen me një zanore tjetër janë të mesme: *ftoi*, *punoi*.

### Zanore të shkurtra

Zanoret e theksuara të pjesoreve, të cilat, megjithëse sot në këtë të folur, dalin pa prapashitesën trajtëformuese **e**- prap, zanoren e theksuar e kanë të shkurtër: *kam mleth*, *a keni rrit*, *nrys*, *kemi gjet*. Në të folmen e Peqinit diftongu **ue**- është monoftongimi në **u**, por në Darsi (malësi) ndeshemi edhe me dyzanorshin **ua**, tendencë e të folurës letrare, që flitet në jug të Darsisë. Kryesisht atë e gjejmë në rrokje të hapur në fund të fjalës: *thua*, *frua*, *grua*, *prrua*, *mua*, *dua*. Gjithashtu ndeshen trajtat me **u** (**ue**) *pru*, *gru(e)*, *prru(e)*, *nigju(e)*, **ie**-, *i mill*, *dill*, *qill*. - diftongu **ye**- *y kmyn*

(*këmbyn*) *kthy*, *pyti*, *thyn*. Grupi **vo-** në krye të fjalëve ruhet: *voj*, *votra*, *i vokët*, *i vorfën*, *vojt*. Bashkëtingëllorja **-h-** në fillim të fjalës ruhet rregullisht: *hudhni*, *hanga*, *hamell*. Në këtë pozitë bashkëtingëlloren **h-** e gjejmë edhe në fjalët: *heci*, *hiki*. (H-ja grykore bie pothuajse në sy në të gjithë zonën e Peqinit). Kur **h-**ja ndodhet në trup të fjalës vërejmë: Ajo ruhet si e tillë: *lahem*, *luhet*, *lihet*, *duhet*, *krahët* (kraht)<sup>5</sup>. Në trup të disa fjalëve nuk dëgjohet fare: *t (h)oll* (petët); *le (h)t - let*, *afro (h)u*, *bo (h)çe*. Kur ndodhet në fund të fjalës (**h** fundore) në një pjesë të fjalëve zëvendësohet me **f**: *e njoft* (njoft), *gjynaf* (gjynaf), *rref* (rref), *mçef* (fsheh). **Th-**ja në qytet, Malësi e Darsi dëgjohet si **-th-** që përfaqëson një **-th-** grykore. Ky tingull ka si të thuash një artikulum të dyfishtë, meqenëse përfshin njëkohësisht edhe një nuancë grykore të elementit ndërthëmbor të tij që përfaqëson bazën e këtij tingulli. Dua të theksoj se ky element është më e veçanta e të folmes së Peqinit. Ky tingull përdoret në fjalë pavarësisht nga pozita: *thes*, *thik*, *thrrret*, *i math*, *e gjitha*, *djath*. Këtë tingull e gjejmë edhe kur bashkëtingëllorja **-th-** është përfituar edhe nga shurdhimi i bashkëtingëllores fundore **-dh**: *erth*, *huth*, *north*. **Nj-**ja fundore nuk është ruajtur në Peqin. **Nj-**ja e temës së emrave, **nj-**ja e mbaresës së emrave në shumës, si **nj-**ja e mbaresave të foljeve në kohën e tashme ka evoluar në **j**, në **i-** zakonisht kur është e temës: *mulli*, *gishti*, *dielli*, *florij*, *ullij*, *thëngjij*. **Nj-**ja ruhet në disa raste, kur vjen nga grupi bashkëtingëllor **-ngj-** (*njal*, *thenjill*, *njit*, *njesh*). Mosshqiptimi i bashkëtingëllores **b**, **d**, **g**, **gj** te grupet **mb**, **nd**, **ng**, **ngj**: *pellam*, *mlesë*, *kom*, *plum*, *miner*, *fun*, *ner*, *menje*, *ven* etj. Pra vëmë re qasje të gegërishtes. Zëvendësimi i bashkëtingëllores **-r-** me bashkëtingëlloren **-n**: *emën*, *femën*, *bojna*, *dituni*, *dimën*, *pluhun*. Zëvendësimi i bashkëtingëllores **-r-** me bashkëtingëlloren **-n-** dhe rënia e zanores **-ë-**: *gërshon*, *hapsin*, *bojna*<sup>6</sup>.

### Theksi

Në të folmen e Peqinit përdoren sot e kësaj dite një numër i madh fjalësh turke. Tek disa fjalë theksi bie në rrokjen e fundit, siç janë: *bakllava*, *tabaka*, *mushama*, *penxhere* etj<sup>7</sup>. Fjalët e huazuara nga turqishtja, në të folmen e Peqinit, kanë përgjithësisht të theksuar rrokjen parafundore: *kastile*, *hyzmet*, *sumbull*, *zahmet*, *djepe*, *zhele*, *xhezme kaffe*, *qoshe*, *pare*,

<sup>5</sup> në këtë rast bie ë-ja.

<sup>6</sup> Këto fjalë janë zëvendësuar me fjalë të gjuhës standarde, gjuhë e cila përdoret në shkolla dhe në institucione.

<sup>7</sup> Në një numër më të kufizuar fjalësh ruhet theksi në rrokjen fundore.

penxhere, bakllava, tabak, pasha, vaki, sajdis, belqimt, zerzele, trahana, mide, xhinaz.

### Tiparet morfologjike të së folmes së Peqinit

#### Emri

Dhe në të folmen e Peqinit vërehen të tria gjinitë e emrit: mashkullore, femërore dhe asnjane. Vihen re emra që mbarojnë me **-i-**, ose **-u-** në numrin njëjës, trajta e shquar, rasa emërore si: *biçaku, çerjepi, hajati, shkomi, konaku, kokoshi, rrengu*, etj., apo emra të gjinisë femërore që mbarojnë me **-a-ja** - *baullja, mortja, fterja, sapllakja, trina, sofra, cakorrja, nona, katruvja, rona*, etj. Në Peqin janë femërorë edhe këta emra: *tulja, dheja, strehja, tela*, ndërsa mashkulorë janë emrat: *furri, qilli, qulli*. Por vihen re dhe emrat e njerëzve që mbarojnë me **-o** të patheksuar, por gjinia e tyre përcaktohet nga seksi: *Qamo, Lumo, Taso* etj. Jo rrallë hasim dhe emra të gjinisë asnjane, si: *grunt, të vjelat, t'mbromat, t'korrinat*. Disa emra të veçantë që tregojnë lëndë nuk janë ruajtur në Peqin. Ato janë zëvendësuar kryesisht nga gjinia mashkullore: *mjaliti, leshi, voi*. Gjatë shqyrtimit të emrave të përdorur janë vënë re këto dukuri të shumësive të emrave Shumësi me **-a** përdoret në vend të shumësive me mbarsën **-e-**: *kraha, qorra* që del njëllë si njëjësi i shquar: *dega, maja*, me mbarsën **-e-**: *gruzhde, qorre*. Me jotizim të bashkëtingëllores **-ll-**: *kërmilla, turtlla, fylla*. Shumësi me **-e** - *fustane, fyje, yje, plugje*. Shumësi me ndërrim të kuantitetit të zanores së theksuar (rrënja e mbarsës kompensohet me zgjatjen e zanores së theksuar): *dajak, qyrek, binar, dolla, dyshek, gomar, dyfek*. Shumësi me palatalizim: *zoq, uq, bulq, fiq*. Shumësin me mbarsën **-j** e marrin emrat që kanë pasur dalë me temë me bashkëtingëlloren **-nj-** e cila në disa raste është shtuar analogjikisht: *kercej, kushurij, kalastrej, huj, thoj, ftoj, pathoj*. Shumësi me mbarsat **-ij, -ej-**: *drapij, lumej, prrej*. Shumësi me mbarsën **-na** (që bie në sy në të folmen e Peqinit): *ujna, gardhna, bollna, barna, pillna, pyllna, drujna, prrojna*. Shumësi me mbarsën **-as** - *vorras, prrallas, breshkas*. Shumësi me ndërrimin e zanoreve të fonemës, p. sh. *gjerdhe* (gardh), *shqeme* (shkam), *tren* (tra), *gjethe* (një gjethe), *vllazën* ose *vllazëni* (vlla), *kren* (kokë), *desh* (dash), *qipshte* (kopësht), *shqerra* (qiq).

#### Trajta dhe rasa e emrave

#### Rasa emërore

Shumica e emrave femërorë dhe në ndonjë rast edhe emrave mashkulorë dalin në trajtën e pashquar me një **e-** të shtuar në temë: *cohe, krahe* por marrin edhe **j**: *kolerje, vapje*.

- Zanozja o- përpara bashkëtingëlloreve **r, ll**, në trajtën e shquar të emrave mashkullorë në përgjithësi ruhet e padiftonguar: *qeshori, krahnori*, trajta e pashquar: *peshir, kallnur*.

- Emrat mashkullorë *thu, kru, prru, ftu, patku* në trajtën e shquar marrin i: *thoi, kroi, ftoi, patkoi, prroi* etj. Në Peqin krahas trajtës thoi ndeshet edhe trajta *thuni*.

- Emrat mashkullorë që në trajtën e pashquar mbarojnë me zanore hundore **a, e, u, i** në trajtën e shquar shtojnë bashkëtingëlloren para zanores i: *zani, kufini, hini, kallini, gjuni, peni*. Në Vrap është hasur *treni – trau*.

#### Rasa kallëzore

Për emrat mashkullorë karakteristike është mbaresa **-n-** para së cilës dalin përgjithësisht zanoret epentetike **-i-** dhe **-u-**. Këto janë format më të përhapura në krahinën e Peqinit: *leshin, dreqin, millin, bereqetin, sqeparin, kushurinin, urizin, shokun, bregun, grekun, zogun*. Mbaresa **-n-** u shtohet emrave që mbarojnë me zanore: *kan (kau), shin (shiu), min (miu)*. U shtohet dhe emrave që në të pashquarën mbarojnë me **j**: *vojn, fojn, bejn*.

#### Rasa gjinore

Bie në sy mungesa e nyjes së rasës gjinore: *funi shpis, gazi shpis, Teqja madhe, mjalt'i shpis* dhanore, rrjedhore. Mbaresën **-e-** e gjejmë rregullisht në toponimet: *Fusha-ullijet, shport- ullijet, kodra-varrezet* dhe sidomos në toponimet të cilat vijnë nga emra fisesh: *Prroi Dervishet, Çifliku Kunet, Prroi Farrufet, mhalla Arapet, Stani Bedallet, gryka Gjate, Kodra Conet*. Mbaresa **ve-** haset kur emrat mbarojnë me zanore në rasën gjinore e dhanore shumë: *i qigravet, syvet, gjave, qeve*, i hasim dhe tek emrat: *pulvet, çunvet, hijvet, fushvet*. Në të folmen e Peqinit përdoren shpesh trajta me mbaresën **-sh-** për rasën rrjedhore të pashquar tek emrat e gjinisë femërore *para shokësh, prej katunesh*.

#### Përemrat

##### Përemri vetor

Forma më e përhapur e përemrit vetor të vetës së parë, njëjës, në rasën emërore është **un**. Në Darsi ka dy forma: **mu, muve** (dhanore, kallëzore), më rëndom haset - **muve** në qytet e në Darsi. **Mu** (në Malësi) p. sh. *Fmia m'ngjan muve. M'i ka marr mu*. Përemri i vetës së dytë, njëjës **ti**, në rasën dhanore e kallëzore del në trajtat **ty, tyve**: *ty t'thhash, se t'kam pa un tyve. T'kërkohet tyve qo (kjo)*. Për vetën e parë shumë, rasa emërore dhe kallëzore përdoren në të gjithë Peqinin tri trajta: **ne, neve, na** (takohet kryesisht në Malësi); - *Ne e kuptum*. – *Erth shpejt e shpejt*. - *E kena venos na*. Rëndom haset dhe **tyve** (veta e dytë, njëjës, rasa dhanore e kallëzore).

*Ty t'thash se ku t'kam un tyve. Veta e parë shumë -ne, neve, na (përdoren të tri trajtat). Ishte me neve. Na i tham. Ne s'e kemi ashtu.*

#### **Përemri dëftor**

Njëjësi femërore del në emërore vetëm në trajtën **qo** (kjo). *Qo* (kjo) është toka ime. Përemri dëftor i rasës emërore njëjës, i gjinisë mashkullore në Malësi dhe në qytet del **ky**. *Ky* e di. Në Darsi (numri njëjës, gjinia mashkullore) përdoret **qy** (ky). *Qy* (ky) s' durohet. Në rasën kallëzore **ky**, del **kte, kit** p. sh. : *Kte se jof sot me ket dit.* Në gjinore – **i ktij, i kt'ita**. Siç e shikojmë ka një shtesë fonetike: *fisi i kt'ita*. Në rasën rrjedhore njëjës **ky, kjo**, dalin për të dy gjinitë, në trajtën **ksi**: *prej ksi vakti, prej ksi punësh.*

#### **Përemri pronor**

Përemrat pronorë të vetës së parë dhe të vetës së dytë në rasën emërore e kallëzore, prona e pronari, dalin përgjithësisht pa nyje: *Mos e luj, a imi*. Ka raste që del dhe me nyje: *i imi, e imja*. Veta e parë, numri njëjës, gjinia mashkullore del **im**, veta e dytë, numri njëjës, gjinia mashkullore, **-yt** (jot). Veta e parë, numri njëjës, gjinia femërore **teme** (ime), **jote**, (m) **im, tem**, (f) **teme** (ime), (m) **yt, tat**, (f) **jote, tate**. **Teme** (Darsi); **ime** (qytet): *Djali im, vajza ime, ime moter, im vella. Djalit t'im, vajzës teme, vajza jote, vajzës tate*. Përemri pronor veta e dytë, numri njëjës, rasa emërore, prona dhe pronari dalin kryesisht me trajtën **yt**, kurse **jot** ndeshet më rrallë. Përpara emrave të farefisnisë del në trajtën **tyt**: *tyt vlla*. Hasen dhe format: a-) **e jonja**; b-) **atij** (*zavensi atij*). Përemri i tij, zëvendësohet gjerësisht nga përemri vetvetor (i, e, të) **vet, shpin e vet**.

Përemri lidhor, **i cili**, nuk para haset, në vend të tij mund të përdoret përemri i palakueshëm **qi**: p. sh. *Aj qi* (i cili) *rri n'hant*.

#### **Përemri pyetës**

Më shpesh përdoret: **kush?** Në rasën kallëzore përdoret forma: **çin**, p. sh.: *Çin (kë) ke caktu me shku atje*.

#### **Ndajfoljet**

Ndajfolje vendi: *njat* (afër), *ka* (këtu), *posh* (poshtë), *tytje* (tutje), *cipër* (sipër), *ktu* (këtu), *qark e përçark* (rreth e rrotull), *përmys* (përmbys), *knej* (këtej), *përmrena* (brenda), *përdhe* (poshtë në dysHEME). Ndajfolje kohe: *ime, imena, imen* (tani), *nesret* (të nesërmen), *masanej* (pastaj), *tohera* (herët e tjera), *seftemen* (në fillim fare), *pervonjë* (mbasditë), *përmjezi* (në mëngjes), *nasht'i* (tani).

#### **Foljet**

Foljet që i përkasin zgjedhimit të parë, koha e tashme, mënyra dëftore në të shumtën e rasteve përkrijnë me gjuhën standarde, mbarojnë me -j: *qaj, qan, qan, qajmë, qani, qajnë; tregoj, tregon, tregojmë, tregoni*,

*tregojnë* (kjo folje del dhe dëftej). Përmendim dhe rastet: *psoj* (pësoj), *mshij* (fshij), *narkoj* (ngarkoj), *knoj* (këndoj). Foljet e zgjedhimit të dytë, që në pjesore dalin me t-, mbarojnë me s-, në vetën e parë njëjës e shumës dhe në vetën e tretë shumës: *qis, fus, prashis, godis*. Në Vrap - *qit* për *qis*. Në qytet *krasit* për *krasis*. Disa folje të parregullta e supletive nuk marrin mbaresa në tri vetat e njëjësit: *du, do, do, ha*. Në disa raste marrin mbaresën **n-**, në vetën e tretë e të dytë. *Pi, pi, pin, vi, vjen, vjen*.

Folja **kam**. Për vetën e parë të shumës në të folmen e Peqinit ndeshen disa forma të foljes **kam**: *kena, kimi*. Për vetën e dytë dy forma: *keni, kini*. Në Darsi kemi edhe trajtat **ki** (e) **mi, ki** (e) **ni**.

Folja **jam**. Dhe për këtë folje ndeshim katër forma në vetën e parë shumës: *jemi, jimi*, (imi), *jena, jina* (ina); në vetën e dytë shumës: *jeni, jini* (ini).

Folja **them** *th* (h)*em; th* (h)*u; thot* (njëjës), *th* (h)*um; th* (h)*una; them, themi, thoni, th* (h)*uni, th* (h)*oni*.

Koha e pakryer del në disa raste: *shkojsha, punojsha*.

Koha e ardhme del: *do* + folje; *do dali, doe* (ta) *kapërcesh, do shkoj, do kthej koha, do mëçifna*. Dhe rastet kur del t-ja i prapangjitet foljes ndihmëse **do**: *do pim uj, dot njasim, o ta çel*.

### Format e pashtjelluara

#### Pjesorja

Në Peqin, në qytet, takohen pjesoret me **-m, -um, -un**: *kapun, zaptumun, dalum, nrefun hangëm, rritem, blem, ndigjum, bisedum, fejum, bamun, narkumun, marumun, folun, pjekun, pasun, lagun, vujtun, ledhatumun, qethun, fjetun, majtun, nejtun, punum, ftum, jetum, martum, huazum, ram, vum, pam, damtum, krijum, investum, largum, lexum, përjetësum*.

#### Paskajorja

Vihen re: **me** + **pjesore**: *me punu, me mill* (mbjell); **për** + (emër i gjinisë asnjëse) **pjesore**., *për t'shit, për t'korr, për t'punu, për t'msu* etj. : *shkoi për ta nimu; m'vun për t'flet; me + **pjesore**: ; *don me harru; vjen me m'ngatrru; shkun me punu; Erth me pa; për me + **pjesore**: ; *Erdhën për me m'marr*.**

#### Përcjellorja

Variantet me të zakonshme janë **tuj** dhe **tue**: *tuj menu, tuj pi, tue gdhi, tue ardh*.

#### Ndajfolja:

Në të folmen e Peqinit hasen disa dukuri gjuhësore tipike: ndryshimi i rrënjës: *ime-nime* - tani; mosshqiptimi i bashkëtingëlloreve **b, d, g** te

## E folmja e Peqinit dhe vendi i saj në strukturën dialektore të shqipes...

grupet **mb, nd, ng**: *mrena, përmys, knej, anej*; përdorimi i disa formave të veçantë të ndajfoljeve a shprehjeve ndajfoljore: **përqark**, *shkonte përqark*; **cipër** - *i rrinte cipër mi kokë*; **mat'here** - *mat'here i iu mush menja*; **ime, nime** - *Ime erdha*; **përqark** - *I ra përqark*.

### E folmja e Peqinit në kuadrin e Atlasit Dialektologjik të Gjuhës shqipe

Është bërë një studim i Atlasit Dialektologjik të gjuhës shqipe, ku janë veçuar ato tipare gjuhësore në varësi të përdorimit të së folmes së Peqinit.

#### Hartë përgjithësuese

##### Tipet e sistemit të fonemave zanore të theksuara

Zanore gojore të gjata hasen në Peqin. / **a**/ -/ **ua**/ *gjat, ftu*,

- Fonema bashkëtingëllore/ **rr**/ dhe kundërvënia e saj me fonemën/ **r**/ : *rruaj-ruaj*. Ekziston kundërvënia / **r**/ -/ **rr**/

- Fonema bashkëtingëllore/ **th**/ -*them*

- Fonema bashkëtingëllore / **n**/ - *ngushtë, kungull, trung, lëng*. Në Peqin ekziston/ **n**/. Në rastet kur del trangu “lëng” - “lank”, **n**-ja është variant fonetik, jo fonemë.

- Grupi i bashkëtingëlloreve/ **mb**/ dhe shpërndarja e tij në kushte të ndryshme fonetike. Ky grup nuk ekziston. Në vend të tij qëndron/ **m**/, kurse në disa pika ka / **b**/, ose/ **p**/: *Mbjell-mjell, kumbull-kumull, thumb-thum*.

- Grupi i bashkëtingëlloreve/ **nd**/ dhe shpërndarja e tij në kushte të ndryshme fonetike (*nder - ner, këndoj - kënoj, shkund - shkun*) nuk ekziston. Në vend të tij ka **n**/ *ner*/, / *kënoj*/, / *knoj*/, / *shkun*/

- Grupi / **ng**/ nuk ekziston në të gjitha kushtet fonetike. Në shumicën e fjalëve ka / **n**/ në vend të grupit.

- Kategoria e gjinisë të numërori ka 2 forma: një me zanoren/ **y**/ të shkurtër, për mashkulloren dhe një tjetër me zanoren / **y**/ të gjatë, për femëroren (*dy-dy*)

- Forma dhe variantet e formës së përemrit pronor, të vetës së II, me pronë njëjës dhe pronar shumës, femëror, në rasën emërore (*juaj-juej, juj*)

- Fonema zanore e përparme e ngritjes së ulët, e gjatë, gojore/ **a-ae**: /, / **e**/ *Ti the, ti le, ti re, ti pe, s'kam nge*.

- Fonema zanore e theksuar/ **a**/, *ban=bën*.

- Fonema zanore e theksuar/ **i**/, *u mpi-u pi*.

- Fonema bashkëtingëllore/ **h**/ hundore ekziston në të gjitha kushtet fonetike (në fillim, në mes, në fund): *ha, duhan, lahet, krah*

- Numri i zanoreve të theksuara / **i-e-a-o-u-ë**

-Kategoria e gjinisë së numërorit **tre-tri**.

-Ka dy forma: një për gj. mashkullore, me zanoren / **e**/ dhe një tjetër me zanoren / **i**/ (*tre-tri*)

-Variantet fonetike dhe variantet leksikore të përemrit të vetë së parë, njëjës/ **unë**/.

Në Peqin përdoret / **una**/ (*unë-una*)

-Variantet fonetike të përemrit vetor, veta III, njëjës, gjinia mashkullore / **ai**/ dhe në Peqin përdoret / **ai**/ (*ai-ai*)

-Varianti fonetik i përemrit vetor, veta III, nr. njëjës. gj. mashkullore / **ajo**/ . Në Peqin përdoret / **ajo**/ (*ajo-ajo*)

-Forma e rasës emërore e përemrit vetor të vetës së parë, nr. shumës / **ne**/, dhe në Peqin del / **ne**/ (*ne-ne*)

-Forma e përemrit vetor, veta II, nr. shumës/ **ju**/ në Peqin del / **ju**/ (*ju-ju*).

-Variantet e strukturës së përemrit pronor të emëruar/ **imi**/, në Peqin përdoret me nyje të përparme / **i imi**/ (*imi-i imi*)

-Forma dhe variantet e formës së përemrit pronor, të vetës së parë me pronë dhe pronar njëjës, femëror, rasa gjinore, dhanore, njëjës, / **sime**/, në Peqin del / **time**/ (*sime-time*)

-Variantet e përemrit pronor njëjës, femëror, rasa kallzore/ **time**/, në Peqin del / **time**/, / teme

-Fonema/ r/ në përbërjen e fonemave të atyre fjalëve që dikur, sh. herët, janë prekur në dialektin jugor prej rotacizmit, kthimit në/ **r**/, të/ **rr**/, ndërmjet dy zanoreve: *dimër-i, bri-ri, pleqëri*, veshur. Shtohet se në Peqin, për sa u përket formave të përemrave vetorë / **ju**/, / **ty**/, / **ne**/, / **mu**/ bie në sy dalja e tyre në format: / **juve**/, / **tyve**/, / **neve**/, / **muve**/.

Fill pas këtij studimi është bërë një anketim me djalin e Mustafa Çeçit (Anketues i ADGJSH), nga i cili u dha një informacion i bollshëm me vlera në drejtim të një tradite mjaft të pasur kulturore të vlerave shpirtërore dhe shoqërore.

### Synetlliku

Kur bohej fmija synet, në komt e fmis vihej një dyshe (shami). Aty hudheshin lekë. Këto lekë pasi maronte punë, berberi e mlidhte dyshen dhe ikte bashk me lek. Çunit i guditesh dysheku i ri me çarçaf të moth, ku në mes të çarçafit me një kokërr grun të madh sa medhësia e grushtit, mblidhet mes çarçafit dhe lidhet me një fije dhe fija lidhet në tra. Kështu, çarçafi bëhet në formen e një çadre, që djali të mos lëndohet. Kënga që këndohet: O berber, të keqen o, ty të lumshin duart o, / O berber, të bëj

## E folmja e Peqinit dhe vendi i saj në strukturën dialektore të shqipes...

rixha, mos ma bëj çunin me qa. / Në të qaftë, mor usta berberi, / Mbushja gojën më llokum sheqeri; / Në të qaftë, mor usta Vahiti, mbushja gojën me tul simiti. / O mor çun, mor qaf zambak, / Hajde t'xhvishesh në konak, / Hajde, mor bab, nema dorën se s'mun t'vishem se jam i vogël. / Kur ta bëjm çunin sznet, rrafim sazet 7 net, / 7 net e 7 dit plot furrat me simit.

### **Vdekja**

Pasi vdes, bazhija (personi që trashëgon larjen e të vdekurit që është grua mbi 50 vjeç) pasi e ka la, i hedh në goj 2- 3 filxhana uj qi të jete i nopur, i lidh gojn, e qefinos të vdekmin, i knon një syr qi quhet (telkim). Ma pas merret i vdekmi dhe çohet në konakun (oden-dhomën) ku e qajn grat. Veni është i shtruar me dyshek, çarçaf të endur pëlhere, jorgan sipas moshës së të vdekurit, me ngjyr t'kuqe për t'rinj dhe blu për ma t'moshumit. Ke koka i venoset një nape e cila i mlon ftyrën. Para se ta lanim t'vdekmin i prisnim një tuf flok për me lan mbarsin n'shpi

Qyteti i Peqinit ka veshje karakteristike për vajza - Këpucë të bardha me taka dekolte - çorape të bardha pamuku të qenisun me ornamente popullore - fund pëlhere i bardhë - takemb prej mermeri me ushkure te këmbët i veshur me stof të butë, ngjyrë vishnje, i qëndisur me temina të verdha sipas formës së dëshiruar. Veshja e burrave nuk ndryshon nga veshja karakteristike e veshjeve të burrave të Shqipërisë se mesme dhe veçoritë e saj karakteristike janë: -opinga prej lëkure boj kafe-çorape leshi me ornamente popullore me ngjyrë karakteristike kuqe + zezë-penebreke të endura në vegje, pëlhurë e bardhë - qillota prej shajaku të bardha, të gjera tek xhepat, të qëndisura me ornamente-brez prej pambuku me ngjyrë të larmishme, këmisha pëlhere e bardhë, e qëndisur me ar.

- Martesat e para kanë qenë në grupe, martesat që duhet të kryheshin detyrimisht brenda fisit. Dhe pak më vonë burrat dhe gratë filluan të qëndronin bashkë dhe filluan të krijonin familje të veçanta. Këto familje lidheshin ndërmjet tyre nëpërmjet një njohjeje dhe finalizoheshin me një martesë.

### **Nga folklori**

Qyteti i Peqinit është shquar gjithmonë për një traditë mjaft të pasur kulturore, e cila vë në dukje vlerat shpirtërore dhe shoqërore të këtij qyteti në shekuj. Këtë traditë e spikatim dukshëm edhe në vlerat folklorike që përbëjnë në vetvete mendësinë dhe shpirtin e vërtetë të tij. Duke qenë trevë e Shqipërisë së mesme, Peqini këngët dhe vallet i ka me motive të tilla. Ndonëse nuk njihet ndonjë kompozitor popullor janë të njohura tashmë këngë që kanë origjinën në këtë qytet si: “K'no moj qyqe se erdh behari/ Se ç'na u dogj stani i Bedallit” Kënga tjetër: “Do shkoj lala në Peqin / Do

t'knaqet shpirt'i im." ose: "Për midis kalldromit o, / Mora rrugën shkova, / Aman Mine, aman Nure, / Aman moj, se më sëmune." Këto hasen në zona të thella ku kanë si zakon dërgimin dhe bluajtjen e misrit në mulli dhe shoqërohet me këto këngë. Zogjt e dades jan' ba gjela/ Zogjt e dades jan' ba gjela/ o dad' o gjel-o/ Zogjt' e botës harabela. O gjel-o/ Zogjt' e dades hajn' uriz. O gjel-o/ Zogjt' e botës kput n'kuris. O gjel-o/ Zogjt' e dades na hajn' grunë. O gjel-o / Zogjt' e botës jan' semune. O gjel-o Hani gjela tuj kullotë. / Hani gjela tuj kullotëdad, o gjel -o !/ Mbushni, gjela, gushën plot !/ Hani gjela, se u ba vonë. / Shkoi sahati tet' a none, o gjel-o! Kënga këndohet nga vajzat me fyt (duke prekur laringun memgisht'in e madh), kur kullosin gjelat e det'it. Ajo këndohet kështu për t'i dhënë një dridhje të veçantë. Nga dëshmitë e ndryshme mendohet se kjo mënyrë e të kënduarit duhet t'i përkasë një tradite vokale të lashtë, të trashëguar nga periudha e stërgjyshërve tanë ilirë. Te këto vargje shikojmë kundërvënien e kujdesit të bashkëfamiljarëve nga njëra anë dhe pakujdesinë e të huajve nga ana tjetër. Ndër vallet përmendim vallen e Peqinit: "Mu ke ara ke tagjia" Këngëtarët më të dëgjuar, për të cilët ruajnë akoma nostalgji qytetarët e Peqinit, kanë qenë: Besnik Tosku; Skënder Ramazani. Ndryshe nga motivet e këngës qytetare peqinase e ato të malësisë së Peqinit, këngët e vallet popullore të zonës së Darsisë janë me motive të sazeve të jugut. Rrethi i Peqinit përfaqësohet në festivalet folklorike kombëtare me grupin e tij folklorik.

#### **Fjalë të urta të qytetit të Peqinit**

Fjalët e urta të paraqitura më poshtë kanë një tematikë të larmishme. Ato i dedikohen vendlindjes, familjes, jetës, njeriut, shëndetit, miqësisë, gjendjes shpirtërore, punës, pasurisë etj. Gruja e mir të shton ymrin. / Mos kërko mill në qill. / Hajde ujdj mre kacen, hajt n'Peqin e pun mos bën. / Mikun provoje para se t'ja kesh nevojën / Davaja të vej si të vej, mullini të jet i beut. / Ç'del prej macen gjuan për minj. / Njëqind goj, një goj e mbyllur. / Neqezi s'të jep gur me ça kryt. / Ene pula, qi asht pul, po t'vi mbramja zëvenin e vet. / E bukur si bota e men si çota. / E di dhelpra kush asht gjuetari. / Fjala të ul, fjala të ngre. / Buk e hi në shtëpi. / Gur i randë, 'vend (d) vet. / Peqini ash ven (d) i but. / Peqini ash ven pullumash. / Vetem Rrap i Bezistanit asht venali. / Ai që s'ka gru e fmi, s'njef bot e pereni. / Po rrite 'i fmi, ke be i xhami. / Eh kjo jeta! Nji pal hovin, nji pal zbresin, nji pal lejnë, nji pal vdesin. / E mira dhe e keqja s'kanë fun (d). / Jetën si e çon, çehrja e tregon. / Pleqni, moj pleqni po ta dije si je t'i, do menoja qysh n'rini. / Qefi ma ka, b. ... s'ma ma. / Shnet'i ash mirnia ma e madhe. / Vdekja zgjeth, nuk mleth. / Kur m'ka keq shpirt'i, s'më hyn n'sy gjo. / S'vjen gjo vet drejtë n'goj. / Po s'u lodhe, s'ke gja n'torbet. / Duhet

E folmja e Peqinit dhe vendi i saj në strukturën dialektore të shqipes...

kuvet'i, po duhet dhe alet'i. / Di nana t' baj laknur, po çe do, s'ka qypi voj. / Paren që fitohet pa djers, se kam neze. / Po s'hume të dashmen, s'fiton të dhimshmen. / Bli gomarin, masanej samarin. / Ç'bi dekika, se bi mot'i. / Ne e durumja gjer me 'i ven shkon. / N'gjo lalen tat, se e kam pa ma par dillin. / Sa t'rrojsh, ma do msojsh. / Gjesdisi sa gjesdisi, asgja nuk bit'isi. / Ma të kesh dituni, sa mirni. / Shtat'i pyll, menja fyll. / E njef në t'mirën, në t'keqen, po menja vetëm ke e keqja i shkon. / Gjon e keqe se gjen gjë. / Bën mir e gjë keq. / Kija inatin, veç jepja hakun. / Me mjez, vin për qerelez. / Njeriu rron vetëm për një nere. / Thamë se shpëtum, por ma keq e msum. / E thanmja me t'bamen, jan larg. / Hall me burr, hall pa burr, hall të mos martohesh kurr. / Kur s'ta man, mos ban za. / Fol t'mar vesht: flet me ment e tuja apo me ment e huja. Urime: Gëzofshi njoni- tjetrin! Honkshi bukën e omël! Ju knoftë zemra! dhe mallkime: T'nect n'fy! U bafsh lomsh! Të ardhit mas qafe! Mos pafsh dill me sy! Ju mbyllt dera me i deg ferre!

Shprehje (njësi frazeologjike, urime, mallkime). - Vdeksh e u bëfsh lomsh/ E kam menjën prapa/ U ftofsh në tajare. / Merre qen e haje dos. / Vdeksh e u bëfsh lëmsh. / U shembën malet, u ngritën halet. / Dil shpirt të dalësh. / S'kapet as me gjethe fiku. / E bani kuturbi. / Është i rrahur me vaj e uthull. / Ha qen e mos kuis. / E nxorën çipllak. / Tre qe një ka balash. / I ka zën b. ... dhjomë. / U bëfsh lëmsh. / Qejf për kokrrën e qejfit. / S'ia bën syni tërr. / I vari noçkat. / Nuk man në kunj. / Mos e përmyjerr. / Keq me qe e keq me buj, por më keq me qet e huj. / Nuk ka pas shtru buk, n'vakt'it. / Nuk mban kollan. / E ka zan domlla. / Çin e ma çin. / E mori si huta zogun. / Jeta s'asht dyst. / Meno se ka pleqni. / Njeriu bohet dy her fmi. / Për ta përplas një mas murit. / Dil shpirt të dal. / I ka zan rrota bisht'in. / I ka komet e lidhme. / Jemi në një tallaz t'madh. / Lena për së dyt'i. / Me shpirt nër dhamë. / S'bi gja prej qilli. / Asht shif e shkruj. / Qit'i dimnin me t'vetat. / Gjen qumësht dallanyshje. / I bani hi e pluhun. / Jan peni kput. / Mos prit gja prej narracit. / I ka hy lepri n'bark. / Po m'nalton zemra. / Shtangu n'vent. / Ta numuron n'lule t'ballit. / Si goc e mlume. / S'ka vu men hiç. / E bani tërkuz. / Ma venin tat. / Leu e bini ktu. / Mos fut hunët ke s'tre takon. / Qefi ha kumlla t'tharta. / Si qeni që lçohet nga zinxhiri. / S'mund t'i thush i fjal se hypin bubujt. / Asht buk e mykme. / Gjon ruje sa e ke. Ke qef ta ngjosh. / Se bon dot at ve. / Si kan dal hala dhamt e qumshit. / Ta blen menjën me t'pame. Duket qysh n'surrat. / Asht për t'i pre kryt. / I ma veshët pipëz / Kërkon veç të necet. / I vu kamën / Ma hoqi llokmën e gojës. / Osht njeri i mlut. / E dreth fjalën si ma do. / Me çin flet, me murin. / U rrasallitem ranshëm. / S'të lçon nga duret kollaj. / I ka vdek

nana ksaj pune. / Ma nill zemra. / S'me nrof. / Ma nill zemra. / As knej, as anej. / S'di çin t'mash e çin 'tflash. / S'di ka t'ia mash. / Ta përsnyn keq. / Se hek nga goja. / S'ma gja të mçeft. / E bone që t'flasi me vete. / Ta varish për kamësh. / I nriji nuri. / E ka n'rranx t'veshit. / E qerun n'mat çast.

### **Vlerësime për qytetin e Peqinit**

Elvia Celebi (Muhamet Dhil-li Ibni Dervishi) ka qenë udhëtar e kronist i njohur gjatë periudhës së pushtimit otoman në shek. XVII. Shumë anëtarë e studiues të kësaj periudhe i janë referuar shënimeve të tij të viteve 1660-1670. Duke u nisur nga rëndësia historike që paraprin këto shënime po shkruaj çfarë ai ka shkruar për Peqinin. "... Kështjella e Peqinit është e ndërtuar për të siguruar rrugën Elbasan-Kavajë-Durrës-Boshtovë nga kusarët dhe iu vu emri turqisht Beshlej, i cili në kalimin e kohës u shndërrua në Peklin e më vonë në Peqin. Peqini është një qytet i hijshëm, i stolisur me vreshta e kopshte dhe i pasur me ullinj, shegë, fiq, limona e portokalle, i rrethuar tej e përtej me lisa e plepa. Këtu gjendet çdo gjë...".

A. Heckuant (mjek francez me 1980) shkruan "... Në mes të Peqinit ndodhet një Pazar, një xhami elegante dhe një kullë në shërbim të sahatit ...". Edith Durham (kroniste angleze) ka shkruar shumë, nga udhëtimet në Shqipëri, për zakonet e jetën e shqiptarëve. Ja çfarë shkruan gjatë udhëtimit nga Elbasani për në Shkodër më 1910: "... U nisëm herët në mëngjes për në Durrës nëpër rrugën Egnatia. Kaluam në Peqin. Rruga romake ishte shkatërruar (me qëllim) pothuajse e tëra. Një konsull i huaj më tha se e kishin shkatërruar me qëllim turqit kohët e fundit, në tërbim e sipër që të kishte sa me pak rrugë që të ishte e mundur. Në Peqin i thashë hanxhiut se qyteti më dukej i vogël dhe ai ma ktheu aty për aty: - Edhe floriri i vogël është, por vlerën e ka të madhe. Dëgjova qyqen që këndonte dhe e pyeta ç' thoshte populli për të. Më tha se kur e dëgjon për herë të parë duhet të hash diçka dhe gjithë vitin do të kesh bollëk për të ngrënë...".

### Carls Telford Erikson (veprimtar politik amerikan)

Më 1908 bashkë me Nolin e Konicën i ka dërguar memorandum Presidentit Uillson për mbrojtjen e Shqipërisë, duke propozuar një Shqipëri nën protektoratin amerikan. Më vonë u përfshi si delegat i shoqatës patriotike "Vatra", ku veç të tjerëve ai shkruan: "... Në Peqin shkuam të vizitonim kryezotin e rajonit, Demir Pashën. Na patën informuar se serbët kishin bërë zullum në pronën e tij. Në kopshtin e shtëpisë gjendej një hendek i gjatë, që kohë më parë ishte mbuluar me dhe. Në të ishin hedhur kufomat e atyre të cilët për ndonjë arsye ose pa farë arsye qenë therur nga bajonetat serbe. Pasi i lanë disa orë të ekspozuar para

## E folmja e Peqinit dhe vendi i saj në strukturën dialektore të shqipes...

---

banorëve i hodhën në gropën e hapur në kopsht të Pashait. E pra këtë nuk e kupton dot kaq lehtë, nëse nuk e njeh Ballkanin.

### Sami Frashëri

Në botimet e tij në Kostandinopojë shkruan: "... Peqini është një qytet i vogël, qendër e kazasë në Sanxhakun e Elbasanit të vilajetit të Manastirit. Ndodhet në buzë të një fushe pjellore, rrëzë malit, në të djathtë të lumit Shkumbin 26 km në lindje të bregdetit Adriatik dhe 30 km në perëndim të Elbasanit. Shtëpitë i ka të shpërndara nëpër kodra të veshura me pemë. Ka vetëm 1800 banorë. Në mes ka një pazar të vogël, dy xhami, një teqe, një medrese dhe një kullë sahati, meqenëse përreth mbillet oriz, ajrin e ka të rëndë. Kazaja e Peqinit kufizohet nga lindja me Kazanë e Elbasanit, nga veriu dhe perëndimi me Sanxhakun e Durrësit të vilajetit të Shkodrës, nga jugu me Sanxhakun e Beratit të vilajetit të Janinës. Shkumbini është një lumë në Shqipërinë e mesme. Buron prej maleve të Starovës (nga malet e Mokrës), kalon pranë qytezës së Peqinit. Rrjedha e tij është afërsisht 160 km dhe konsiderohet një vijë ndarjeje në mes të gegëve e toskëve...".

### **BIBLIOGRAFI**

- Adam, I., *Rrugët e Shqipërisë në kohë antike*.  
Buletini, I., *Për shkencat shoqërore II*, 1953.  
Çeliku, M., *Vëzhgime mbi të folmen e Peqinit*, në *Studime filologjike IV*, Tiranë 1965.  
Gjinari, J., Shkurtaj, Gj., Gosturani, Xh., *ADGJSH*.  
Inalçik, H., "*Suret-I Defte-I Sançak-I Arvanid*" te, 1432 (*Hixhri 835*).  
Labov, W., *Some Linguistic Principles, Sociolinguistics*, C. B. Poulson and Richard Tucker, U. S. A, 2003.  
Shkurtaj, Gj., Gjinari, J., *Dialektologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë 2003.  
Shkurtaj, Gj., *Sociolinguistika e shqipes*, Tiranë, 2009.  
Trudgill, P., *Sociolinguistic variation and change*, Great Britain, 2002,  
Veith, G., *La campagna di Durazzo Fra Cezare e Pompeo*, Roma 1942.

